

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 1-rë e rendit të ditës – Miratimi i rendit të ditës.

Elvi Cuni – Sekretar i Këshillit Bashkiak

Bën apelin e këshilltarëve. Marrin pjesë anëtarë të këshillit bashkiak.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Pershendetje të gjithëve. Siç keni dijeni materialet i keni në dosje të gjithë, prandaj unë kërkoj miratimin e rendit të ditës. Kuorumi është vazhdojmë me rendin e ditës. (Lexon pikat e rendit të ditës.)

E hedh në votim rendin e ditës.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Referuar neni 77 pika 5 të rregullores për dokumentacionin shtese sic ne e kerkuam në komisionin e ekonomisë për pikat 8 dhe 9 të rendit të ditës që janë tranferime granti dhe financime projektsh që kanë qënë të miratuara nga Bashkia në favor të projektit të Rrugës “Arif Dardha” dhe pajisjeve fotovoltaike të godinës së re të Bashkisë, informacioni është kërkuar në komision ditën e premtë dhe vjen sot para mbledhjes. Materiali është shumë voluminoz dhe propozoj që pika 8 dhe 9 të hiqen sot nga rendi i ditës që ne ndërkohe të konsultojmë materialet për aq kohë sa do kërkojë qartësimi për këto 2 projekte dhe diskutimet, fizibiliteti e reminishenca për këto 2 projekte, duke qënë që janë anashkaluar i jep vlera të rëndësishme në favor të tyre. Këto janë për komisionin e ekonomisë.

Pika tjetër është për vendosjen e një ushtari ilir ku Zj. Rudina Mita, anëtare e komisionit më referoi që nuk ka pasur asnjë diskutim, pra komisioni nuk u realizua për këtë pikë. Si pasojë edhe kjo pikë bie, nuk mund të miratohet.

Pika tjetër është për komisionin e strehimit ku në komision u kërkua dokumentacion shtesë mbi përbërjen e komisioneve dhe formulën e pikëzimit, gjë që ne sot nuk e kemi prezente. Kjo gjë sipas rregullores bën që këto 4 pika të mos jenë në rend të ditës.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Për pikën 17 vendosjen e monumentit të një ushtari ilir në murin e Kalasë, ne ishim prezen në komision në orën 13.15 dhe u diskutua si pikë.

Rudina Mita – antare e këshillit bashkiak.

Unë kam ardhur në orën 13 sipas lajmërimit dhe Z. Elvi më tha që mbledhja e komisionit mbaroi. Kërkoj të respektohet orari, gjithashtu kërkoj të di ku do vendoset ky monument, kush është qëllimi, çfarë vlere ka, pra dua një informacion, ose relacion për këtë pikë. Nuk kam asgjë kundër.

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Përsa i përket proces verbaleve të mbledhjes së muajit gusht por edhe të mëparshmet, është e disata herë që nuk na vihen në dispozicion në zbatim të rregullores. Nëse nuk publikohen në faqen e Bashkisë sepse mund të ketë ndonjë problem, sugjeroj të na futen në dosje. Ne duam të dimë çfarë e si diskutohet.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Për pretendimet e Zj. Madhi për pikat 8 dhe 9 të na jepet një sqarim nga administrata e Bashkisë.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë

Atëherë, materialet e kërkuara në mbështetje të pikës 8 dhe 9, kanë qenë, çfarë është bërë në momentin e fazës së parë në lidhje me investimin e projektit rrugës “Arif Dardha. Është një material përmbledhës të cilin ne e vumë në dispozicion të këshilltarëve duke ia futur në dosjet e tyre, edhe pse ky material është voluminoz, është plotësisht i lexueshëm.

Relacioni teknik në lidhje me punimet që do kryhen, sepse miratimi i materialeve që futen sot në këshill bashkiak ka të bëjë vetëm me fondet e supervizimit dhe kolaudimit jo me fondet e investimit në vetvete që është një proces më vete. Investimi rrugës “Arif Dardha” është një projekt i cili është kërkuar nga Ministria e Financave dhe fondet për vitin 2023 kanë qënë të parashikuara në buxhetin e Bashkisë të v. 2023, dhe ky relacion është publik dhe është në faqen e APP-se prej 20 ditësh, se çfarë përmban ky relacion dhe çfarë punimesh do kryhen, dhe përveç kësaj e kanë të gjithë në e-mail-in e tyre të gjithë kryetarët e

grupeve. Ky është një relacion teknik dhe komisionet përveç që i kanë miratuar sipas procedurave, këto janë thjesht materiale që nuk afektojnë materialet e paraqitura sot, por thjesht kërkojnë një opinion të përgjithshëm, një informacion të përgjithshëm se çfarë është bërë me këtë investim.

Përsa i përket studimit të fizibilitetit të fotovoltaikëve, ai është venë në dispozicion. Vërtet është një material voluminoz, dhe duke qenë që ky studim është realizur në bashkëpunim me "GIZ", janë këta partnerët që na paraqitën materialin, dhe ky material na erdhi dje i pa përkthyer (në gjuhën angleze) dhe kjo bëri që ne ta fusim sot.

Ndërkohë që për procedurë i gjithë informacioni i kërkuar në raport me komisionin e strehimit, ai është thjesht një formalitet, pasi kërkohet se kush ka qënë komisioni i mëpqrshtëm Me një mundim shumë të lehtë këtë informacion do ta gjeni në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak sepse edhe vitin e kaluar Këshilli Bashkiak ka ndjekur të njëjtën procedurë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Pikë së pari, komisioni i strehimit që u mbledh, kishte vetëm 2 anëtarë dhe ishin kryetari dhe unë. Si mund të funksionojë një komision që në përbërjen e tij ka 7 anëtar. Kjo gjë ka funksionuar edhe në komisionet e tjera. Ju lutem ta futim këshillin bashkiak në situatë institucionale, ju thashë edhe më parë nuk mund të funksionojë një komision me 2 vetë pa pasur kourumin e nevojshëm. Ne qofte se ju nuk merrni masa që komisionet të kenë pjesëmarrjen e duhur, kjo mbledhje nuk mund të konsiderohet e vlefshme. Pra ky komision duhet të rimblidhet. Ky material sot nuk mund të kalojë. Nuk mund të kalojë në rend të ditës një material që ju vetë nuk e keni miratuar. edhe antarët tuaj nuk ishin në komision përveç kryetarit. Kaq e qartë është. Nuk funksionon komisioni me 2 antarë.

Edhe një pikë tjetër që unë e parashtrova edhe mbledhjen e krijimit komisioneve. Në përbërjen e komisioneve, në kryesinë e komisioneve, neni 33 thotë – komisionet do përfaqësohen në % nga secili grup.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ju lutem mos filloni nga e para pasi e mbyllëm atë temë.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Jo, sepse këtu filloi gabimi.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Ju lutem bëjeni kërkesën me shkrim.

8

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Do jua dërgoj unë kërkesën me shkrimJ Do ja drejtorj institucionit përkatës.Ju nuk mund t'i hiqni të drejtën e përfaqësimit të opozitës në komisione. Ti je gardian i rregullores, kjo nisi që tek miratimi i përbërjes së komisioneve.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

As mund ta ve dhe as m und ta heq këtë të drejtë.Komisionet do kryesoheshin 7 nga mazhoranca dhe 5 nga opozita.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

5 komision et e opozitës duhet të ndaheshin në bazë të 5 qe i takonte.Mazhoranca ka 6 komisione me kryetarë. Ne si institucion i rëndësishëm duhet të zbatojmë rregulloren. Në miratimin e komisioneve të përhershme nuk pate as 30% të antarëve për të firmosur Madje Zj. Protokollit thoshte gjatë gjithë kohës po ikin këshilltarët pa firmosur.Ju lutem stadin procedural kalojeni në situatë institucionale, sepsen është e turpshme që ne të bëjmë këto lloj diskutimesh..

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak

Në zbatim të rregullores cdo këshilltar duhet të vijë në komision, nëse nuk vjen 3 herë rrjesht, atëherë ka masa përkatëse.Kjo që thoni ju është e vërtetë, por rregullorja do zbatohet me korrektësi.Nuk është e drejtë që nëse nuk vinë anëtarët e një komisioni kjo pikë nuk do shqyrtohet. Ka masa për këshilltarët të parashikuara në rregullore.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Atëherë komisioni të mos funksionojë?

Erion Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Për procedurë, dhe për të shmangur këtë lloj kakofonie,Qytetarët sot nuk janë këtu dhe të na dëgjojë për procedurat e brendshme.Komisionet kur mblidhen të hartojnë një relacion për materiale që diskutojnë dhe ta firmosin kush ka votuar pro dhe kush kundër dhe të futet në dosje.

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak

Në bazë të relacionit do flas për të gjitha pikat e rendit të ditës, ato që për mua janë për tu sqaruar dhe ato që janë për tu diskutuar. Për pikën 2 e preku Zamiri dhe unë jam plotësisht dakord Për pikën 3 jam dakord,është më së normale të stimulohen nxënësit e dalluar. për pikën 4 për përbërjen e komisionit strehimit, jam dakord, për pikën 5 – formula e pikëzimit jam dakord .

9

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak

Ju po citoni rendin e ditës?

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak

Jo, të lutem por për pikën 4 kam problem tek pikëzimi. ose është bërë ndonjë gabim ose kërkon një sqarim.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak

Ju lutem ta diskutojmë hap pas hapi.

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak

Ok, jam dakord ta diskutojmë hap pas hapi.

Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak

Pëershëndetje. Jam dakord dhe me të tjerët për mos pjesëmarrjen nëpër komisione. Ateherë si përfaqësues i komunitetit Mysliman jo në aspektin politik, komisione apo mbledhja e këshillit bashkiak të mos caktohen ditën e premte ora 13, pasi ne shkojmë në Xhami dhe pjesëmarrja në komision është e pamundur.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim rendin e ditës ta miratojmë në përgjithësi.

Këshilli bashkiak me 25 vota pro, 9 kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Valbona Balliu – anatare e këshillit bashkiak

Ju lutem edhe një herë sa vota ishin pro rendit të ditës? Duhet 50% + 1.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Jo duhet 50 % e pjesëmarrjes. Të rinumurohen edhe njëherë votat.

Atëherë miratohet rendi i ditës miratohet me 27 vota pro, 9 vota kundër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 2-të e rendit të ditës – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së muajit Gusht (dt.31.08.2023).

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Proces verbali i mbledhjes duhet të zbardhet brenda 10 ditëve, 10 ditë ka kohë dhe Prefektura të miratojë aktet. Kjo mbledhje ishte pak si shpejt në krahasim me mbledhjet e zakonshme dhe kjo është arsyeja ose do ketë ndonjë arsye tjetër. Përgjegjësinë e mbajmë ne si staf., unë dhe sekretari këshillit.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi ÇUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 3-të e rendit të ditës – Për mbështetjen financiare të nxënësit Alden Moria.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe aseteve publike.

Ne si komision i financave e shqyrtoam këtë material, dhe bashkia bën shume mirë që financon dhe motivon këto talente që ka qyteti jonë. Si komision jemi dakord.

Arbi fetah – antar i këshillit bashkiak.

Përveç kësaj propozoj që Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të motivojë gjithmonë nxënës të talentuar dhe ekselentë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Bashkia ka pasur gjithmonë raste të tilla që ndihmon e motivon nxënës të tillë, por në këtë rast ne merremi me burimin e shpenzimeve dhe financimit të këtij nxënësi

Vesa Lico – N/Kryetare e Bashkisë

Bashkia Elbasan gjithmonë ka financuar për këta nxënës ekselentë dhe i ka mbështetur gjithmonë këto raste.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash, miraton sa më sipër. Vota kunder dhe abstenime nuk ka.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 4 -tërt e rendit të ditës – Për miratimin e ngritjes, përbërjes, dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit Bashkia Elbasan.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Bashkia Elbasan ka përfaqësuesit e saj nga drejtori të ndryshme në këtë komision, kështu që ka dhe përgjegjësi dhe meritë për ngritjen e këtij komisioni.

Rexhep Kaculi – Kryetar i komisionit të shërbimeve dhe strehimit social, shëndetësisë dhe barazisë gjinore.

Përshëndetje. Sot na kërkohet vetëm si numër komisionerësh dhe drejtoritë përkatëse që do kenë përfaqësuesit e tyre në komision, dhe asgjë tjetër. Kjo është thjesht formale, është pa emra. Propozojmë ta miratojmë.

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Dua të theksoj se në material të shtohet Komisioni Strehimit pranë Bashkisë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Është vërejtë e drejtë. Le të mbahet shënim që të reflektohet.

Valbona Balliu – anatare e këshillit bashkiak

Propozoj që ky komision të ketë dhe një antar tjetër nga Këshilli Bashkiak, sepse nuk mund të funksionojë që ky komision të jetë tërësisht institucional, tërësisht në duar të Bashkisë, pa pasur asnjë përfaqësues nga këshilli bashkiak, i cili më pas ka përgjegjësinë për të kaluar çdo fond dhe çdo detyrim për cka ndodh në komision. Edhe njëherë ju them që komisioni nuk u mbledh, prandaj nuk diskutoi asnjë

6

element pikëzimi, dhe pikëzimi mund të ketë nevojë për ndërhyrje për shtesa të tjera etj. etj. Prandaj kërkoj një informacion shumë të detajuar.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, 4 kunder, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

Votuan kundër –Doris Madhi, Rudina Mita, Artan Kana, Amarda Murati.

Abstenuan – Valbona Balliu,

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 5-të e rendit të ditës – Mbi miratimin e formulës së pikëzimit për aplikantët në programet e strehimit social.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë

E sqaruar edhe në komision pyetjet për kriteret e pikëzimit, ndërkohë që numrat e pikëzimit që janë vendosur për secilin kriter është në bazë të sasisë së kërkesave që kemi ke database i programit të strehimit. Kjo është për t'i ardhur në ndihmë atyre shtresave apo disa kategorive të cilët janë më të shumtë në numër për strehim. Këtu vihen re disa kategori që janë në kushte strehimi, në kushte familjare, ku gjithë pikëzimi i aplikantëve futet në një formulë ligjore që është shumë e qartë dhe komisioni merret vetëm me anën procedurale dhe nuk është një komision vendim marrës që merret me anën që zgjidhet një aplikant apo një tjetër. Pasi bëhen publike të gjitha kriteret dhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit, komisioni për pikëzim pasi bën verifikimin e dokumentacionit për secilin aplikant i fut në formulën e pikëzimit dhe pastaj nxjerr listën ku në bazë të fondeve të rendit nga i pari deri tek i fundit. Nëse disa kriteret janë vlerësuar me pikë më të larta se sa ai i renditjes, kjo listë ribëhet edhe një herë. Kjo vjen për shkak të numrit të madh të aplikantëve.

Valbona Balliu – anetare e këshillit bashkiak

Ne kërkuam një listë me numrin e aplikantëve, dhe ju na thatë ta gjejmë në faqen e Bashkisë. Por në faqen e Bashkisë nuk ishte.

Aulona Bylykbashi – N/Kryetare e Bashkisë

7

Ju kërkuat edhe për komisionet e mëparshme dhe komisionet e mëparshme janë me vendim të këshillit e të publikuara në faqen e këshillit bashkiak.

Valbona Balliu – anatare e këshillit bashkiak

Kërkuam sistemin e pikëzimit që keni përdorur në komisionet e mëparshme.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, 1 kunder, 3 abstenim, miraton sa më sipër.

Votuan kundër – Artan Kana

Abstenuan – Rudina Mita, Ergys Muzhaqi, Armonela Marku.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 6-të e rendit të ditës – Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan.

Shfaqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe asetëve publike.

Edhe kjo u diskutua në komision dhe u miratua. Është një godinë pranë lagjes “5 Maji” e cila plotëson disa shqetësime e probleme që kanë disa shtresa të shoqërisë tonë. Bëhet fjalë për t’i ardhur në ndihmë grave dhe vajzave të dhunuara. Komisioni është dakord.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 7-të e rendit të ditës – Mbi dhënie në përdorim, (pa kundërshpërblim) të një ambienti (klasë) të shkollës së mesme të përgjithshme “Dhaskal Todri”, Qendrës Protik.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Edhe kjo u diskutua në komision.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 8-të e rendit të ditës – Detajim i shtesës së fondeve (grant) dhe transferim fonde nga të ardhurat, për vitin 2023.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe asetëve publike.

Edhe ky projekt vendim kaloi në komision. Meqënëse rritja e pagave për punonjësit sipas VKM-së përkatëse, kërkon një shtesë fondi si nga qeveria dhe nga Bashkia, kjo e fundit ka bërë përlogaritjet përkatëse dhe ka siguruar të ardhurat për këtë fond.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, 1 kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Votoi kundër - Valbona Balliu.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 9-të e rendit të ditës – Mbi miratimin e fondeve shtesë për projekte me bashkë-financim.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Nuk kemi më nevojë për shpjegime se i morëm shpjegimet dhe atë ditë në komisione e diskutuam dhe në komision që ky material të zhvendoset për herën tjetër, vetëm që të jemi pak më të qartë. Tani me forcë kartoni ju e miratoni. Ngrini kartonin dhe u miratua. Fjala ime është kundër shumicës por unë në zbatim të rregullores po flas. Gjithashtu ju duhet të merrni parasysh dhe përgatitjen profesionale që ka secili nga ne. Konsultimi i këtij materiali nuk është ndonjë shkencë e madhe, pavarësisht se është voluminoz. Unë thjesht kërkova që ky material të shihet për mbledhjen e ardhshme, nuk kërkova ndonjë gjë të madhe..

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E ngrite këtë edhe në komision por materiali i ardhur është domethënës, është bindës.

Doris Madhi – antare e këshillit bashkiak.

Se si bindesh ti është puna jote. Por unë ta thashë dhe atë ditë në komision unë jam pro në parim për çdo vendim që do marrë këshilli bashkiak në lidhje me përmirësimet e kushteve të jetesës së komunitetit, dhe në parim do jem gjithmonë pro kësaj, ama për të parë realizmin se si realizohen këto projekte e para kam të drejtë të shikoj si qytetare, e dyta si këshilltare e treta si profesioniste.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak **me shumicë votash pro**, 10 kunder, 1 abstenim, miraton sa më sipër.

Votuan kundër – Ergys Muzhaqi, Rudina Mita, Artan Kana, Valbona Balliu, Amarda Murati, Altin Mecja, Majlinda Kaculi, Bjanka Copja, Doris Madhi, Naim Meta.

Abstenuan – Aurora Domni,

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 10-të e rendit të ditës – Për ndryshimin e VKB nr. 58 datë 26.05.2023, “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2023”.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe aseteve publike.

Ne si komision e pamë edhe këtë material. Kërkohej një ndryshim projekti për riparimin e e argjinaturës së Zaranikës, e cila kërkon një shtesë fondi, po ashtu dhe për urën e varur në Polis Valë. Komisioni është dakord.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 11-të e rendit të ditës – Miratim i ndryshimit të nivelit të pagave, në zbatim të vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe shpërndarjes së numrit të punonjësve të administratës së bashkisë dhe institucioneve vartëse.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe aseteve publike.

Edhe këtë e pamë si komision. Është një VKM për rritjen e pagave të administratës. Është një vendim që stimulon punonjësit e administratës dhe Bashkia ka paraqitur këtë material për rritjen e pagave të administratës. Komisioni është dakord.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 12-të e rendit të ditës – Ndryshimin e emrit dhe numrit të punonjësve të Institucionit vartës Qendra e Trashëgimisë Kulturore.

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe aseteve publike.

Komisioni i financës e pa edhe këtë projekt vendim. Ligji i jep kompetencë kryetarit të Bashkisë të krijojë strukturën e Bashkisë. Në këtë material ka krijuar Agjensinë e Kulturës, për punët kulturës të turizmit, së bashku me numrin përkatës të punonjësve. Komisioni i financës është dakord.

Aurora Domni – anëtare e këshillit bashkiak

Kërkoj një sqarim për Bibliotekën , shikoj këtu Nr 8, është për administratën apo vetëm për iblotekaret?

Vesa Lico – N/Kryetare e Bashkisë

Pika 8 është për stafin e Bibliotekës dhe njëkohësisht është si pikë mbështetëse, ku përvec bibliotekareve ka edhe punonjës që merren me shpërndarje të informacionit nëpër shkolla, si dhe shpërndarje të librave në to për nxënësit etj..

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 13-të e rendit të ditës – Ndryshimin e emrit dhe numrit të punonjësve të institucinit vartës nga “Agjensia e Shërbimeve Publike” në “Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale” dhe krijimi i Agjensisë të Shërbimeve Publike Urbane

Shefqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe asetëve publike.

Edhe këtë projekt vendim e pa komisioni financave. Është një ristrukturim që mendon Kryetari i Bashkisë për të rritur efektivitetin e shërbimit si në qytet por edhe ato rurale. Krijimi i këtyre drejtorive është në të mirë të shërbimeve publike infrastrukturës rrugore dhe sistemit kullues. Komisioni është dakord.

Aurora Domni – antare e këshillit bashkiak

Kjo pikë dëshmon se reforma territoriale ka dështuar rrugës, sepse ashtu ishte, u bë ndryshe, dhe tani sikur nuk ekziston.. Unë jam pro pasi është më mirë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me shumicë votash pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 14-të e rendit të ditës – Krijimi i Agjensisë së Pyjeve dhe Mjedisit.

Shfaqet Bullari – kryetar i komisionit të financave, buxhetit dhe aseteve publike.

Edhe këtë projekt vendim e pa komisioni i financës e ra dakord pasi ka të bëjë me një ristrukturim të kësaj drejtorie të Pyjeve e cila ndahet në dy pjesë. Njera prej tyre do merret me bujqësinë, e cila do merret me punët e problemet e bujqësisë në zonat rurale dhe tjetra me veterinarinë, mjedisin, pyjet. Të dyja bashkë krijojnë Agjensinë e Pyjeve dhe Mjedisit. Komisioni është dakord.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Një gjë duhet të keni të qartë, tek këto Agjensi nuk ka ndryshime numri të punonjësve.

Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak.

Cfarë ndryshimi ka Agjensia e Pyjeve nga ajo e AshPR-së?

Gledian Ilatja – Kryetar i Bashkisë Elbasan.

Përshëndetje të gjithëve. Ju uroj suksese si këshill bashkiak mbasi është mbledhja e parë që këshilli bashkiak bën me prezencën e administratës Bashkisë. Ju uroj që ky këshill bashkiak ka debat dhe angazhim politik për të gjithë ata që ju shohin dhe mua si kryetar bashkie më bëhet qefi, pavarësisht se edhe me këshillin e mëparshëm kemi pas debate konstruktive, për zhvillime, organizime të ndryshme etj. por kemi pasur marrdhënie të mirë dhe janë marrë vendime të mira në të mirë të punëve të qytetit e qytetarëve në të mirë të Bashkisë së Madhe. Edhe një herë ju

uroj suksese për punën që do bëni në të mirë të qytetit por edhe për cdo fshat. Sot ka pasu shumë ceshtje për shkak të procesit të zgjedhjes së komisioneve të përhershme, prandaj ka shumë materiale të akumuluar sic është dhe ai për mbulimin e shpenzimeve të nxënësit tonë të dalluar i cili na nderoi me pjesëmarrjen në Olimpiadën e Matëmatikës, ku gjej rastin t'ju falenderoj dhe ju që e miratuat këtë material, për mbulimin e shpenzimeve të transportit për këtë nxënës. Ne si Bashki gjithmonë kemi mbështetur raste të tilla.

Gjithashtu ju falenderoj edhe për mbështetjen që dhatë për ambientin e shkollës "Dhaskal Todri" dhënë Qendrës Protik, ku një pjesë e mirë e të rinjve do e shfrytëzojnë atë në fundjavë kur nuk kanë mësim. Kjo gjë i shërben zhvillimit të të rinjve, dhe unë si kryetar Bashkie jam përpjekur gjatë gjithë kohës të mbështes zhvillimin e të rinjve, duke përdorur organizimin e kurseve profesionale në fushën e zhvillimit të teknologjisë, informacionit komunikimit etj.,

Po bëj një përmbledhje të shkurtër për materialin që është paraqitur sot për ASHPR-në. Kjo Agjensi funksionon si një e vetme dhe për fshatin dhe për qytetin. Prandaj lindi nevoja ndarjes së kësaj agjensie në dy ndërmarrje të vecanta brenda strukturës së kësaj Agjensie. Nuk është ceshtje politike por doli ceshtje funksionale, ku disa punëtorë për shërbimë të ndryshme publike apo mirëmbajtje rruge si në fshat dhe në qytet të sjelli domosdoshmërinë e ndarjes së ndërmarrjes. Është më funksionale që të kemi një grup puntorësh në cdo Njësi Administrative edhe të fshatit edhe të qytetit, po i marrim nga ndërmarrja e punëve publike dhe po i kalojmë në struktura të njësive bashkiake. Kjo bën që shërbime të ndryshme si në fshat e në qytet të përqëndrohen në këto njësi bashkiake, pra të kenë varsi dyfishe edhe nga Ndërmarrja Punëve Publike edhe nga Njësia Bashkiake. Ky është hapi i parë i ndarjes së punëve publike, por më vonë do ndahen edhe asetet dhe do krijohet një personalitet juridik për ndërmarrjen e re që do krijohet. Do kërkojmë më vonë po nga këshilli bashkiak që të mbështeti këtë strukturë të re administrative. Këtë strukturë të re të fshatit do e mbështesim që edhe kjo ndërmarrje e fshatit do e marrë veten, pasi ne do e furnizojmë me mjete të mëdha që ajo do ketë nevojë për të kryer punët e veta. Më vonë do kërkojmë që Njësitë Administrative sipër lumit Shkumbin, si zona e Gjinarit, e Shpatit të kenë ndërmarrjen e vet dhe ato njësi Administrative si Bradashesh, Papër, gracen etj, të kenë ndërmarrjen e tyre të punëve publike. Për fuqizimin e kësaj ndërmarrje unë do ju kërkoj juve mbështetje të madhe në buxhetin e Bashkisë, në mënyrë që kjo ndërmarrje të ketë më shumë fizibilitet, më shume kapacitet.

Sot Agjensia e Pyjeve dhe mjedisit është një Agjensi e Re dhe është strukturuar sipas kërkesave ligjore, por edhe si vizion për të formatuar kërkesat tona në mënyrë sa më efikase. Sot një pjesë e drejtorisë së mjedisit është direkt në varësi te

Bashkisë Elbasan ashtu sic është edhe drejtoria pyjore, ashtu sic është ne varësi të ASHP-së një pjesë e punëve ëe kryhen për bujqësinë, e veterinarinë. Qëllimi ynë është që ti përmbledhim në një Agjensi, dhe ne kemi paraqitur një prezantim të shkurtër , ndoshta ju e dini dhe keni informacion të plotë, nga puna e bërë nga këshilli bashkiak i mëparshëm dhe Bashkia Elbasan, përse i përket fokusit tonë për mjedisin Bashka Elbasan është i vetmi qytet në Shqipëri por edhe në Mal të Zi e Maqedoninë e Veriut, më saktë i treti ne Ballkan që bën pjesë në një mision të madh që ka BE përse i përket ndryshimeve klimatike që ka filluar që nga viti 2021, si dhe projekti “Qytete të Zgjuara”. Është një mision që vazhdon deri në vitin 2030 dhe në fakt në kuadër të misionit ka shumë projekte të BE ku ne si Bashki Elbasani kemi aplikuar dhe po aplikojmë, dhe jemi target grup i ndryshimeve që ne vetë po bëjmë për përmirësimin e klimës, uljen e ndotjes etj. dhe për t’i bërë shërbime sa më të zgjuara dhe afër qytetarëve. Ky është qëllimi jonë. Që para 2 vjetësh në vitin 2021 kemi filluar një sërë planesh për të ulur energjinë që ne konsumojmë si Bashki Elbasan në kopshe, shkolla etj. pra ne po ndryshojmë sistemin e vjetër të ndricimit, me sistem të ri te ndricimit dhe po e kthejmë në ndricim “led” dhe po shfrytëzojmë panelet diellore.. Kemi qëndrueshmëri projekti, si në punët e mjedisit, ato të bujqësisë, prandaj fokusimin do e kemi më të madh tek kjo Agjensi me strukturë të re fleksibël e funksionale. Ju falenderoj të gjithëve dhe jam i hapur për t’ju përgjigjur juve për cdo pyetje.

Erjon Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Në rradhë të parë ju falenderoj që erdhët në këtë mbledhje të këshillit bashkiak dhe na prezantuat materialet. Unë shpreh shqetësimin si qytetar i Elbasanit, si antar i këshillit bashkiak, dhe si më i votuari si këshilltar i KB këtë mandat \, gjej rastin të them se qyteti Elbasanit....

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Mbledhjen e drejtoj unë dhe nuk ju lejoj të flisni cfarë të doni ju.

Erjon Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Ju lutem më lini të ngre shqetësimet kë kam

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Por ju po dilni jashtë asaj cfarë po diskutohet këtu.

Erjon Murataj – antar i këshillit bashkiak.

Po thoja që vota ime është pro, dhe ftoj Bashkinë Elbasan në zgjidhjen e problemit të qenve endacakë. Cfarë është e nevojshme, ta diskutojmë e të zgjidhet ky problem.


Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak **me shumicë votash pro**, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 15-të e rendit të ditës – Për zgjedhjen e kryetarë e dhe kryesive në fshatrat e Bashkisë Elbasan.

Lutfi Lala- Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Në bazë të ligjit 139/2015, zgjedhjet e kryesisë së fshatrave bëhen një herë në katër vjet dhe jo më vonë se 3 muaj nga data e zgjedhjeve, kështu që ne jemi në limitet e fundit të këtyre zgjedhjeve. Ju e keni shumë mirë të qartë por po ju shpjegoj se nga 0-500 banorë të lagjes zgjidhen nga 3 anëtarë kryesie, nga 500-1500 me nga 5 anëtarë dhe mbi 1500 banorë zgjidhen 7 anëtarë. Kjo do të thotë që Bashkia Elbasan ka 116 fshatra, e do të zgjidhen 116 kryetarë fshatrash dhe 490, antar kryesie fshati që janë grup këshillues i kryetarëve të fshatrave. Çdo grup këshilltarësh do të përfaqësohet në cdo mbledhje në cdo njësi fshati. Paraprakisht kam biseduar me këshilltarët të vendosin një emër për të përfaqësuar. Përsa i përket stafit të bashkisë duhen marrë masa të njoftohen administratorët për njoftimet, procesverbalet për zgjedhjet e kryesisë, për zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave, të gjitha këto në bazë të ligjit 139/2015.

Zamir Muzhaqi- Nënkryetarë i Këshillit Bashkiak:

Një shtesë të vogël kisha, sepse ne e pam materialin, datat janë caktuar, paraprakisht është një procedurë e cila duhe të vijojë, thjesht doja që oraret për mbledhjet në fshatra të na vihen në dispozicion, sepse ka 5 apo 6 mbledhje brenda një dite. Ta kemi në dispozicion orarin më para jo në ditët e fundit të mbledhjeve që ne të përfaqsohemi. Me sa di unë në datë 25 fillojnë mbledhjet, duhet ta kemi orarin 2-3 ditë para që ne të organizohemi. Falemiderit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli **me shumicë votash pro**, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi



Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI



Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambientet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 16-të e rendit të ditës – Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik dhe pakësimin në volum të sipërfaqeve që do të përdoren nga shoqëria “Vëllezrit Hysa” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin “rrezlik”, Bashkia Elbasan.

Indrit Abdiaj- Kryetar i Komisionit Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve, menaxhimit ujrave, mbrojtjes së konsumatorit dhe transparencës.

Përshëndetje. Ne në komision e folëm por ka nevojë akoma për diskutime sepse është një rrugë nacionale. Pra kjo leje e dhënë prek rrugën e Gjinarit. Kjo gurore i afrohet shumë zonës së banuar, dhe kjo shkakton shumë probleme në zonë, në shtëpitë e banimit por sidomos në shkolla ku rrezikohet jeta e nxënësve. Pranda propozoj ta diskutojmë me përgjegjësi, që t'i paraprimë problemeve, para se të marrim vendimin, që t'i shmangim problemet aty.

Afrim Qosja – antar i këshillit bashkiak

Përshëndetje të nderuar këshilltarë, kryetar i bashkisë. Si përfaqësues i asaj zone, e njoh mirë atë zonë. Tek materiali që ka skemën bashkalidhur aktualisht gurorja e ka një pozicion dhe duket që ka një ngërç.. Dhënia në përdorim nga ky dokument i referohet vetëm asaj që ekziston. Atje nuk ka pjesë pqër shfrytëzim. Pjesa tjetër që është në hartë nuk është rrezlik. Banorët nuk kanë dijeni të kësaj. Unë sygjeroj që këshilli bashkiak të bëjmë kërkesë AKPN-së të refuzojë lejen për pjesën që zë rrugën, ta shohim me kujdes sepse ka bagëti, është zonë që funksionon për fermerët. Ndikon dhe në funksionimin e jetës së banorëve, pastaj duhet të

shpërngulen banorët pasi do të bëhet zonë industriale. Kjo zonë del jashtë funksionimit dhe bëhet e pa banueshme. Flak për pjesën shtesë, pjesën që kap rrugën dhe atë në të majtë tek harta. prandaj këshilli ta bëjë këtë ndryshim.

Sokol Sinani – antar i këshillit bashkiak

Për planvendosjen e lejes minerare Nr----, kjo pjesë, pra gurrorja aktuale ka problemet e veta, por le të funksionojë. Por pjesa tjetër që kap rrugën nacionale dhe u hap në vitin 2015 nga ARRSh-ja, por dhe pjesa tjetër që i afrohet banorëve shumë, i kërkoj këshilltarëve t'i kërkojë AKPN-së që të revokohet si leje.

Lutfi Lala- Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ka ndonjë pyetje tjetër?

Hektor Ciftja- anëtarë i këshillit bashkiak

Këtu thotë heqje të fondit pyjor. kryetari sapo foli që ne e mbrojmë mjedisin. A do ta lejojmë ne që të zvogëlohet fondi pyjor. Ky është dëm që i bëhet gjithë Shqipërisë.

Artan Kana- anëtarë i këshillit bashkiak

Përshëndetje këshilltarë. Unë këtë e shoh shumë problematike sepse nuk jam pro asaj që ajo që është e përbashkët nga të gjithë qytetarët, ta marrim biznesi për përfitimet e veta. Unë jam kundër kësaj pasi përbën rrezikshmëri për fëmijët që kalojnë aty. Duhet që bashkia të marrim masa, pasi në material shprehet se nuk rrezikon specie të veçanta. Njerëzit janë speciet më të rëndësishëm dhe duhet parë se çfarë përfiton Bashkia dhe çfarë rrezikojnë banorët. Mendoj se duhet ta rishikojmë dhe atë që është aktive aktualisht, se çfarë shqetësimesh kanë qytetarët. Unë dje isha në Shushicë, ku dhe atje ka një aktivitet guror dhe e pashë me sytë e mi problemin. Një qytetar i shushicës me tha se është bërë shumë problematike, zhurma, pluhuri dhe gjithçka që ato shkaktojnë. Të shikohet kjo pikë me vëmendje. Faleminderit.

Sokol Sinani- anëtarë i këshillit bashkiak

Pjesa që punon aktualisht ta heqim nga fondi pyjor. Pjesa e rrugës dhe pjesa tjetër të çohet për revokim.

Lutfi Lala- Kryetar i Këshillit Bashkiak:

E diskutojmë në mbledhjen tjetër.

Aulona Bylykbashi- N/Kryetare e Bashkisë Elbasan

Për këtë material nuk ka cfarë materiali shtesë të jepët. Kjo sipërfaqe është një leje minerare e miratuar në total në të dyja hapsirat. Materiali flet vetëm për ndryshimin e gjendjes juridike të pronës në të cilën zhvillohet, pronë në varsi të Bashkisë dhe nga ministria përkatëse e cila jep lejen. Nëse ka diçka ndonjë kontestim apo vendim marrje, këshilltarët duhet ti drejtohen institucioneve përkatëse. Nuk është diçka që lidhet me administratën.

Zamir Muzhaqi- N/Kryetar i Këshillit Bashkiak

Ta rrëzojmë si projektvendim dhe të shikojmë hapat ligjore që mund të bëjë edhe kryetari i komisionit, dhe anëtarët e këtij komisioni. Unë kështu e shoh .

Erion Murataj- anëtarë i këshillit bashkiak

Fakti që ka kontestime mund të ketë pasur paligjshmëri edhe më përpara. Është më mirë të rrëzohet ky projekt vendim dhe të silltet herën tjetër një material më i detajuar.

Hektor Çiftja- anëtarë i këshillit bashkiak

Tek rendi i ditës emërtimi të jetë që ky fond do të kalojë tek një subject tjetër. Të specifikohet se do ti kalojë ministrisë. Pra formulimi të jetë më i saktë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim propozimin që ky material të kalojë për herën tjetër.

Këshilli bashkiak **me shumicë votash pro**, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 17-të e rendit të ditës – Për miratimin paraprak për vendosjen e monumentit të një ushtari ilir, pranë mureve të kalasë Elbasan.

Vesa Lico- N/Kryetare e Bashkisë.

Bëjhet fjalë për miartimin në parim të vendosjes së një shtatoreje të një ushtari ilir. Besoj se është në ndërin e Bashkisë së Elbasanit, pasi në Shqipëri nuk asnjë akoma që ta ketë bërë këtë. Është vetëm miratim në parim. Kjo është faza e parë, më vonë do kemi një projekt të detajuar të bërë nga ekspertë të fushës, i cili do përcaktojë gjatësinë, gjërësinë, mënyrën artistike, funksionale. Kjo është thjesht për të shprehur vullnetin e mirë për të vendosur një shtatore përgjatë mureve të Kalasë.

Hektor Ciftja – Kryetar i Komisionit të turizmit, trashëgimisë historike e kulturore.

Komisioni nuk ka funksionuar, mendoj të lihet për herën tjetër.

Zamir Muzhaqi – N/kryetar i këshillit bashkiak.

Edhe unë doja të thoja dy fjalë. E vërtetë është që është miratim paraprak, por kështu edhe si këshilltar, duhet të jemi të gatshëm për zhvillime të tilla në qytet, por rikompozimin në qendër të qytetit do doja ta shikoja si dicka më komplekse. Jo vetëm një grup qytetarësh që e kanë të drejtën ligjore por dhe të profesionit, të vendosin për vendosje shtatoresh, kioskash etj. Duhet të jemi më të saktë dhe më të qartë për Qendrën e qytetit, për zhvillimin e saj. Qendra e qytetit duhet të jeta fytyra e qytetit. E them këtë me bindje sepse kam qënë edhe atëherë në këshill bashkiak dhe e kam diskutuar edhe me këshilltarë edhe me specialistë të Bashkisë

se ajo qendër duhet të ketë një rikompozim të qartë. Pra nuk jam kundër vendosjes së shtatores së ushtarit ilir por e kam me merak rikompozimin e kësaj qendre.

Valbona Balliu – antare e këshillit bashkiak.

Dua të shtoj dicka. Ka shumë Kryetarë Bashkie që kanë fatin të lenë gjurmën e vet për të mirë ose për të keq. Prandaj këto vendimmarrje sidomos në qendrat historike sic është Kalaja duhet të jenë të përpunuara të mrekulluara. Duhet të ketë një grup specialistësh që ta shohim nga të gjitha pikpamjet qofte historike qoftë kulturorë dhe ajo që është më e rëndësishmja është që këtë cështje ta vendosë specialisti i fushës, dhe pastaj është kryetari i bashkisë ai që e vendos. Kryetari i bashkisë mund të jetë për shumë kohë, edhe për 100 vjet, por dikur do iki, dhe qendra historike e qytetit mbetet, dhe gjurma ngelet si për mirë ashtu edhe për keq. Përparësia për zhvillimin e qendrës historike të qytetit, duhet të jetë vëmendja juaj, sepse në rradhë të parë ajo do mbajë emrin tuaj. Prandaj duhet të vendosin një grup specialistësh për kë dhe si, dhe jo një grup qytetarësh.

Bukurosh Stafa – antar i këshillit bashkiak.

Këtu duhet të jepet leja për studim paraprak, dhe nuk miratohet vendosja e bustit.

Blendi Himci – anatar i këshillit bashkiak.

Ky është një studim që pavarësisht sa na ngacmon, pasqyron rregullimin e qendrës së qytetit për një atraksion turistik. Pra është një studim goxha i mirë për qytetarët elbasana. Por ajo që ne diskutojmë sot është që Bashkia ka një dokument të rëndësishëm që është rivitalizimi i Kalasë Elbasanit, që është projektuar nga Bashkia Elbasan, nga Instituti Monumenteve të Kulturës, nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore, nga Ministria e Kulturës, nga Universiteti i Pizzës Itali, dhe është një dokument shumë i mirë për zhvillimin e Kalasë. E shoh të rëndësishme jo si vendim politik por e shoh të rëndësishme si vendime në emër të qytetarëve të Elbasanit. Këto janë gjëra që i rezistojnë kohës. Aktualisht, ne shohim që gjatë murit të Kalasë kemi 3 monumente të vendosura, ai i Aqif Pashës, i Lef Nosit dhe i të persekutuarve politikë. Në bisedën që kam pasur me përfaqësuesit e universitetit, një ndër projektuesit, nga universiteti i Pizzës, e shihnin këtë gjë si një gjë të patolerueshme, pasi vetë muri i kalasë në vetvete është monument kulturor. Pra si mund të vendosim 3 monumente për të zhvlerësuar murin e kalasë. A nuk do ishte më mirë që këto monumente të ishin vendosur në vende të vecanta? Ftoj kryetarin e bashkisë në bashkëpunim me administratën të nisë një projekt të mirëfilltë për shpërndarjen e monumenteve të kulturës për murin e kalasë, sigurisht edhe për monumentin në fjalë, pasi po ta avendosin në murin e kalasë, ajo kala është ndërtuar në periudhën otomane, thonë që ka pasur gjurmë bizantine por mbi të gjitha ajo egzistencën e vet e ka si një kala fushore e periudhës mesjetare, dhe ajo

që ne na intereson është se ky lloj kualiteti duhet parë edhe nga pikpamja e mirëfunksionim it të murit të kalasë. E ka pasur në projekt kryetari i bashkisë zhvillimin e kalasë. Si mund të flasim për zhvillimin e kalasë kur pllakat janë moderne dhe muret me gurë, ndërkohë që studimi urbanistik i projektit të rivitalizimit të kalasë është bërë përsëri me gurët e Përroit të Zaranikës. Është bërë analiza e gurëve më të cilat janë ndërtuar rrugët e kalasë, dhe duke e parë edhe nga këndvështrimi im duhet ti kthehemi rrugëve me kalldrëm. Këto duhet të rishikohen pasi këto nuk janë mendimet e mia por të ekspertëve, e specialistëve, prandaj duhet të rishikohen këto për të ndryshuar e për ta bërë më atraktive kalanë. Ne jemi qyteti i parë që kemi prodhuar më shumë akademikë. Ka shumë persona që krijuan akademinë e parë, e këto figura pse të mos jenë në formën e monumentit, të busteve a dicka tjetër. Secili nga ne si anar të këshillit bashkiak, mund të kenë mendim e të ndryshme. Unë besoj që Bashkia duhet të kishte një konkurs dhe të konkuronte me projekte dhe ai komision të vlerësonte atë që do ishte më i miri dhe ekspresiv. Edhe sot kryeministri ka qenë kryetar bashkie dhe këto gjëra me konkurs i bënte për zhvillimin e Tiranës.. Ne po e marrim në sensin pozitiv dhe besoj nuk mund të jetë e drejtë që dikush të thotë po ve x person monument në murin e kalasë. Është paradoksale dhe akoma më keq në vazhdim të kësaj tek monumenti i Camërisë në krah të Hamamit që edhe ky është monument kulture, është vendosur një gabinë elektrike. Ky është një gabim i madh ku në mes të dy monumenteve të vendosësh një gabinë elektrike. Kjo gabinë duhet të spostohet nga aty që t'i japë vlerë 2 monumenteve. A nuk ka vend tjetër për vendosjen e kësaj gabine. Monumenti i Camërisë është shumë sensitiv, dhe padyshim duhet t'i jepet vlera e duhur.

Hektor Ciftja – Kryetar i Komisionit të turizmit, trashëgimisë historike e kulturore.

Së pari i kërkoj ndjesë komisionit të trashëgimisë kulturore për mos pjesëmarrjen time në komision. Dua të them që propozimi për monumentin ilir, është një nga propozimet më të mirëpritur për nga pikpamja nëse ne do kërkojmë një agjensi turistike atraktive për imazhin e qytetit të Elbasanit, dhe në këtë kuptim, që ne quhem i qytet osman. Unë nuk jam kundër kësaj por ajo që mungonte aty është elementi i lashtësisë. Dhe monumenti i një ushtari ilir, i një varri ilir apo dicka tjetër për ilirët do shtonte, apo do theksonte lashtësinë e banimit të kësaj treve, që ka qënë trevë civilizimi, prandaj jam absolutisht pro vendosjes së këtyre monumenteve që tregojnë lashtësinë.. Mund të diskutohet që është monument apo dicka tjetër që simbolizon ilirët. Kjo është çështje diskutimi. Unë do doja që në mbledhjen e ardhshme, komisioni të ketë një pamje të qartë të rivitalizimit të murit të kalasë që të shihet nga ana vizuale se ku mund të vendoset ky bust apo

monument ilir. Jam dakord ta miratojmë në parim, sic tha dhe Z. Bukurosh Stafa, por vendin ta vendosim më vonë.

Arbi Fetah – antar i këshillit bashkiak

Vendndodhja është shumë e rëndësishme.

Hektor Ciftja – Kryetar i Komisionit të turizmit, trashëgimisë historike e kulturore.

Theksoj se vendosja e një varri ilir në anë të murit të kalasë do tregonte lashtësinë. Pastaj diskutimi për monumentet që janë vendosur përgjatë murit të kalasë është çështje shijesh.

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i këshillit bashkiak.

Jo nuk është çështje shijesh, është çështje profesionistësh.

Hektor Ciftja – Kryetar i Komisionit të turizmit, trashëgimisë historike e kulturore.

Diskutimi që monumenti i Aqif Pashës prish pamjen e murit të kalasë është çështje shijesh. Ky është qyteti jonë nuk është i armikut. Pra është çështje shijesh dhe çështje profesionistësh. Diskutime për studimin e murit të kalasë, do ketë monumente apo jo është çështje tjetër. Nëse ne do e hedhim në votim propozimin për vendosjen e monumentit ilir unë jam dakord në parim por mendoj se më parë duhet të kalojë procedurën e komisionit.

Së dyti do doja nga administrata e Bashkisë dhe nga stafi të na prezantojë me paër-point se si do të jetë fasada e murit të kalasë me një pamje të qartë të vendodhjes së monumenteve. Kjo do ishte shumë e rëndësishme. Faleminderit.

Rudina Mita – antare e këshillit bashkiak

Mendoj që kjo çështje që ka të bëjë me trashëgiminë historike, turizmin, rivitalizimin e kalasë etj, duhet të ketë një komision të vecantë specialistësh, ekspertësh, historianësh, specialistë të trashëgimisë historike kulturore, të cilët japin mendime, gjykime në lidhje me vëniën e bustit apo jo, dhe si do realizohet kjo. Kështu që si historiane mendoj që nuk e shoh të udhës këtë, por do ta diskutojmë në komision kur të mbledhemi. E përgëzoj kryetarin e Bashkisë për këto nisma për rivitalizimin e kalasë, por hapat që duhen ndërmarrë duhet të jenë shumë të kujdesshme. E them këtë sepse është një Qendër Romake, një garnizon romak dhe për të ndërtuar këtë sipërmarrje të madhe, duhet të thërresim e të konsultohemi me me ekspertë të fushës përkatëse. Këtë e them nga ana profesionale, pastaj nëse do vendosim me forcën e shumicës apo pakicës, kjo është

gjë tjetër. Por si qytetare e Elbasanit, si historiane e banore e kalasë, mendoj që hapat duhet të jenë shumë të kujdesshëm.

Ergys Muzhaqi – antar i këshillit bashkiak

Si antar i komisionit të trashëgimis kulturore, dua të shtoj dicka, ajo çështja e ristrukturimit të Qendrës Historike së Qytetit që sot paraqitet përvec kalasë, dhe atë që ne kthejmë periudhën e lashtë të qytetit, duhet të bëhet, mbasi duhet të kemi një ide më të qartë se çfarë duhet të bëjmë me shije, me arkitekturë, me histori, me përpunim të dhënash, e të balancimit të grupeve të interesit për qytetarët në historinë e këtij qyteti. Mbasi të kemi një ide të dakortësuar për mënyrën se si do ta ristrukturojmë Qendrën Historike të Qytetit, pastaj të dalim me një listë para qytetarëve. Unë si komunitet mysliman mbledh 2000 firma dhe e kthej Qendrën Historike të Qytetit në qendër fetare. Nuk shkon kështu Duhet të mblidhet të gjithë grupet e interesit, fetare e qytetare e të vendosin me specialiste përkatës.

Artur Guni – N/Kryetar i Bashkisë Elbasan.

Përshëndetje të gjith pjesëmarrësve. Në diskutime po shoh që ka një keqkuptim shumë të madh. Së pari po flasim për një luftëtar ilir dhe jo për një person me emrin ilir, dhe historia nuk fillon me partitë politike. Ne këtu jemi si përfaqësues të qytetarëve dhe ju si këshilltarë të zgjedhur nga qytetarët. Nëse ka një nisëm qytetare nuk duhet ta shohim me zili e me xhelozzi sepse ka ardhur nga qytetarët. Unë jam pjesë e kësaj nisme qytetare të cilët kërkojnë vendosjen e nje luftëtari ilir. Përsa i përket historianëve po ju them se shumë historianë si Neritan Ceka, Ylli Cerova etj. kanë shprehur dakordësinë e tyre për vendosjen e luftëtarit ilir. Pastaj se çfarë doni ju, doni ndonjë romak, ndonjë turk apo ndonjë serb, këtë nuk arrij ta kuptoj. Prandaj mendoj ta kalojmë në parim, pastaj pozicionimi se ku do vendoset ka dhe një konkurs që do bëhet. Përsa i përket anës financiare kanë menduar që qytetarët do të kontribuojnë vetë. Kështu që kjo është një anë e mirë që Bashkia të mos ketë të bëjë me anën financiare. Por do ju thoja edhe një herë që kjo nuk është çështje partiake.

Gledian Llatja – Kryetar i Bashkisë Elbasan.

Kjo ishte një kërkesë e ardhur nga qytetarët dhe s'kemi turp nga e kaluara jonë. Por edhe estetika e murit të kalasë duhet diskutuar. Duhet të ketë një komision që të vlerësojë tamam këtë çështje, që nesër pasnesër të mos bëhemi pishman Ne pjesës së lashtesisë kërkojmë t'i japim shumë rëndësi, kjo shërben për të vendosur një gur themëli për këtë pjesë të historisë, madje po mendojmë që këtë gjë ta bëjmë me cicëron, i cili do japë më shumë detaje për historinë e Elbasanit. Jam dakord me atë që materiali të bëhet më i plotë Jam krenar që qytetarët po vetëfinancojnë këtë

monument, pra ka një sensibilizim qytetar për këtë gjë. Unë mbështes propozimin që ky material të kalojë për herën tjetër e të jetë në formë më të zgjeruar.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Propozoj që ky material të paraqitet në komision në mbledhjen e ardhshme dhe të jetë më i plotë, më i saktë.

Lumturi Hasa – antare e këshillit bashkiak.

Përshëndetje. E përgëzoj këtë nisëm për këtë monument kulture. E përgëzoj edhe si luftëtar i qytetit tonë që është një qytet historik. Falenderoj edhe Z. Himci, i cili ngriti problemin e gabinës elektrike. Si përfaqësuese e Shoqatës Shqiptare të Camërisë, i bashkohem idesë, dhe mendimit të Z. Himci, që kjo gabinë të largohet apo të spostohet. Ne kujtojmë atë masakër atë gjenocid cdo vit. Nuk duhet të lejojmë që kjo gjë të na shqetësojë apo të na kujtojë dhimbjen që duam të shprehim Më 27 Qershor, ne shkojmë cdo vit aty dhe cirojmë dhimbjen që ne kemi, dhe dua t'i them të gjithë shqiptarëve që t'i bashkohen dhimbjes tonë, sepse ne jemi të gjithë shqiptarë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me 36 vota pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika e 18 -të e rendit të ditës – Informacion për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa materialeve të inventarit të Qendrës së Artit Elbasan për vitin 2022.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak.

E hedh në votim materialin.

Këshilli bashkiak me 36 vota pro, kunder, abstenim nuk ka, miraton sa më sipër. (Këshilli bashkiak u informua).

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Doja t’ju bëj me dije: **E para** - me kryetarin e këshillit bashkiak kemi vendur të miratojmë paraprakisht rendin e ditës si kryesi. **E dyta**- e drejta e informimit publik është e drejtë ligjore. Paraqitja live e mbledhjes së këshillit bashkiak duhet të jetë publike. E treta – mbyllja e bulevardit është kthyer shqetësim për qytetarët. Deri kur është ky orar i bllokimit të bulevardit? A ka vendim të këshillit bashkiak për këtë, dhe deri kur është?

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 13.09.2023 , ora 11:15 në ambjentet e Qendrës Rinore “Riemar” Elbasan, mbi zhvillimin mbledhjes së Këshillit Bashkiak Elbasan. Marrin pjesë Kryetari Këshillit Bashkiak Z. Lutfi Lala, 2 N/kryetarët e Këshillit Bashkiak Z. Zamir Muzhaqi dhe Zj. Jeta Ferra, sekretari i Këshillit Bashkiak Z. Elvi Çuni si dhe anëtarët e këshillit bashkiak sipas listës bashkangjitur. Gjithashtu marrin pjesë Kryetari Bashkisë Z. Gledian Ilatja, 3 N/Kryetarët e Bashkisë Zj. Aulona Bylykbashi, Zj. Vesa Lico dhe Z. Artur Guni, Drejtorë Drejtorie, e specialistë të ndryshëm të Administratës së Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse, qytetarë të ndryshëm si dhe media.

Pika të ndryshme e rendit të ditës- Probleme të ngritura nga këshilltarët.

Zamir Muzhaqi – N/Kryetar i Këshillit Bashkiak.

Doja t’ju bëj me dije: **E para** - me kryetarin e këshillit bashkiak kemi vendur të miratojmë paraprakisht rendin e ditës si kryesi. **E dyta**- e drejta e informimit publik është e drejtë ligjore. Paraqitja live e mbledhjes së këshillit bashkiak duhet të jetë publike. **E treta** – mbyllja e bulevardit është kthyer shqetësim për qytetarët. Deri kur është ky orar i bllokimit të bulevardit? A ka vendim të këshillit bashkiak për këtë, dhe deri kur është?

Rudina Mita – antare e këshillit bashkiak.

Ngre shqetësimin për shembjen e çatisë së shkollës “Kostandin Kristoforidhi”. Të shihet ky problem pasi rrezikohet jeta e qytetarëve.

Mbledhja mbyllet në orën 13.10’.

Mbajtëse Proçes verbalit

Xhuliana Abazi

Sekretari Këshillit Bashkiak

Elvi CUNI

Kryetari Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA